

8JH-1

Z 85

PREÇ ZOGAJ

**E pakryer**

Poezi

844-1

2 85

Preç Zogaj  
**E PAKRYER**



**poezi**

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## MËNGJESËT

I keni parë fëmijët në dhomat e mëngjesit  
duke treguar xhamat me duart e vogla,  
dyert e dritës me ngulm duke kërkuar?  
Ashtu bën dhe dashuria ime.

Më ngre si fletë të përndritur: Shpejt!

E joshur nga hapat në rrugë. Shpejt!

Nga një kollë, nga një fjalë,

nga një pasthirmë. Shpejt!

Nga frymëmarrja delikate e pemëve. Shpejt!

Erdha, erdha, mikesha ime, dritë.

Jam edhe unë këtu, një pushkë e rimbushur,  
një krah i lehtë, një buzë e paputhur.

Dritë jashtë meje, brenda meje, pavarësisht  
meje

në pragun e vështimit më vjen dhe ndalet  
si një dorë e zgjatur, kurdoherë e zgjatur  
nga pëllëmbët miqësore të hapura si yje.

Eci, kufijtë i vë syri, i prish hapi.

## M O S H A

Kot isha mërzitur për të qenë njëzet vjeç. . .

Mëngjes e mbrëmje fishkëllen gjaku melodinë  
e zgjimit  
dhe dita s'ka mësuar ende të thotë: ika unë!  
Në pranverë blej këmishë me lule të cilat  
trupi i ngjall,  
sytë e mi pushojnë zakonisht mbi pemën  
në lulëzim.

Pra, kot jam mërzitur për të qenë njëzet vjeç  
fantast, zemërtrembur edhe trim me fletë,  
naiv, bredharak, ndjellamirë i flaktë  
si djelmoshat e rinj me të cilët shkoj ditët.

Me vete flas, por atyre u them:  
Jemi moshatarë, nuk ju mashtroj, djem.  
Jemi moshatarë, një llogari e thjeshtë,  
bëni një zbritje: njëzet e tetë  
minus shtatë-tetë thinja, dy tri rrudha,  
minus maturi dhe meditacion,  
minus durimin e pathyeshëm  
që u kalit vetvetiu megjithëse nuk desha.  
Asgjë tjetër mos zbrisni, se jam plot njëzet.

## Ç'BISEDOJNË TË DASHURIT

Ç'bisedojnë të dashurit, pyesja veten dikur.  
Rrinë, ecin, vijnë kryq e tërthor udhëve tona,  
dy qenie më të ngjashme se deti me qiellin,  
një ditë prej ditësh gati të treten...

Tani që jam rritur, që kam të dashurën time,  
e besoj nevojën për të ecur sup më sup,  
për të folur, për të heshtur...  
Sendet dhe gjërat pa fund të botës  
të dashurit i riemërtojnë  
të magjepsur.

Koha 24-orëshe  
e pakët është për dashurinë.  
Të dashurit sjellin mijëra mesazhe  
për njëri-tjetrin.  
Shihen në sy me sytë e trishtuar lehtë,  
ku orët rrotullohen shpejt e më shpejt  
duke ua rritur moshën.

Jo për t'u ngushëlluar, por nga mirënjohja  
i mbyllin sytë me qepallat e njëri-tjetrit. . .

Nëse ka midis tyre pak zbrazëtirë,  
është vendi i ligjshëm i fëmijëve.

## TI JE E BUKUR

Ti je e bukur, ti je aq e bukur  
sa unë do të largohem prej këtu.  
Nuk duroj  
t'i verej  
pa më parë

sytë e tu.

Në orën tetë treni i mbrëmjes ikën.  
Në mëngjes jam në një qytet tjetër.  
(Qenka e vërtetë se dashuria  
u çelka sy të tjerë drojtjeve.)  
Do të largohem në gji të shokëve  
për t'i ushqyer përsëri  
trimëritë dhe fisnikëritë e mia.  
Do të marr përsipër të tjera detyra,  
këngën e ngadhnjimeve mbi to do ta shkruaj  
pa retorikë, pa patetikë.  
Pastaj do të kthehem prapë këtu,  
ta humb fytyrën në ata sytë e tu.

## FYTYRË E GJALLË

*një veterani*

1.

Sa më shumë jam njohur me Ethem Xhaferrin  
vaji im i ardhmë ka hyrë në borxh.

Po kur t'i mbyllen ata sy të butë –  
pasqyra të pastra të natyrës dhe njerëzve?  
Kur t'i fishket ai mall i gjelbër për punë,  
kur t'i kyçen buzët e qeshura si gjethe. . .

2.

Po vdes, thonë, dhe nuk di se ç'flet.  
Ilaçet e hidhura i la përgjithmonë.  
Kërkon të ngjashmit për t'u shëruar.

Diçka duhet bërë patjetër për të.  
T'i shkruajmë një letër të gjatë dashurie,  
t'i vemi te koka dhe të këndojmë  
dikush përmetarçe, dikush me dyzen,  
me ëndrra të reja t'ia mbështjellim dhimbat. . .



3.

Ethem Xhaferri në dhoga të kuqe  
iku të zbuste më tepër vdekjen.  
Po sytë-pasqyra të natyrës dhe njerëzve  
shëtisin përditë me ne dhe me flladet.

## PARALINDJA E FËMIJËS

1.

Dikur, kur dëgjoja të qara fëmijësh,  
sepse jam trishtuar. Tani  
zili ua kam etërve. . .

Fëmija im është ende në trupin e gruas.

E ndien se është gjallë, herë e pa herë  
bisedojnë ato me një gjuhë të panjohur.  
Provoj t'u qasem me ledhatim e mirësi,  
bëj shpejt pazarin e frutave dhe lodrave,  
por prapë,

ç'sekrete i thonë njëra-tjetrës ato!

2.

Si mbi një arë me lule ecën tani nusja,  
sytë e saj të paqtë herë herë ndalen  
mbi një valle vajzash, mbi një shilarës...

Diçka i thotë fëmija dhe prapë ecën ngadalë  
duke ndrydhur dëshirat.  
Ndonjëherë mbledhur kruspull  
lë amanetet e fundit.

Diçka i thotë fëmija, diçka për mua patjetër  
dhe prapë më vështron e qeshur...  
Tash jam duke gjetur  
mënyra të tjera të jem te fëmija im:

Dje ngjeshja fishekë në mes  
dhe dola për dhelpira,  
një pëllumb më hyri në shenjë,  
por këmbëzën s'e hoqa,  
po lexoj përsëri  
përrallat e një mijë e një netëve,  
po stërvitem të fle copa-copa. . .  
Sot flija nën hijen e ftoit  
dhe më zgjoi fëshfërima,  
sepse edhe te burri  
ndihet gjallë fëmija.

## NDALEM DIKU, VËREJ MËNGJESIN

Shpërgjumje, mendime. . .

Në gjashtë të mëngjesit  
urbani i linjës për qendër nisët.  
Një grua e re në ndenjësën e fundit  
ulet dhe mban frymën.  
Shihemi pak e fjalë s'flasim,  
dhe bluza e saj verore, e lirë  
lagët si muret e Rozafës  
me gjinë që foshnja s'e ka pirë.  
Era nga jashtë hyn dhe vërtit  
te unë flugerin e një malli të lehtë.  
E di, ajo grua zgjohet me yjtë,  
ajo grua ka një foshnje në djep,  
ajo grua e bukur me njolla në bluzë  
që era ia than dhe qumështi ia lag,  
nëpër erë vështron si hapen dy buzë  
dhe kërkojnë përgjumshëm diçka për qark.  
Lëvizje, mendime. . . Në qendër zbresim.  
Një vështrim të shpejtë dhe ikim.  
Ndalem diku, vërej mëngjesin  
si vel i hollë, i dridhshëm.

Befas më duket se e ka veshur  
trupi i brishtë i asaj gruas,  
Tani drita, ajri, jeta  
lahen dhe zbardhen me qumësht.  
Pastaj ky qumësht sikur pikon  
në klisidrën e kohës me ritëm.  
Hapin e njerëzve orkestron.  
Ç'qe e ç'do të jetë prej ditëve.

## PRILL

Prilli vjen me një frushullimë të hollë  
dhe më preh,  
dëshira e njohur e të ecurit më zë.  
Këmbët më dhembin, edhe më shumë  
më therin kur ndalem.  
Kam ftesë nga blirët, nga rrugët,  
nga qielli i pastër, nga malet.  
Tani pranverë është dhe vajzat janë të bukura  
sikur kanë fllade, jo trup nën këmisha.  
Pas hapit të tyre livadh bëhet rruga,  
guximin e djemve ngjallin me qeshjet e çiltra.  
Pa ju them një sekret, se në park më presin.  
Do shkoj?  
Është prill dhe as vetë nuk e di se ç'kërkoj...  
Këmbët më dhembin, edhe më shumë  
më therin kur ndalem.  
Kam porosi për të shpënë gjithandej  
veten time.  
Dhe shtyhem përpara me vrull gjithnjë  
i vonuar  
nga një pemë, nga një lule, nga një pyll  
me vështrime.

## REPLIKË

Trumcakët dhe flladi përtej  
në pyllin e ri  
nuk janë më të gëzuar nga unë —  
fytyrë e qetë, e vrenjtur, e qeshur,  
trup me plagën e gjallë të një bisku  
që shpërthen ditë për ditë.

Nuk mundem, s'do mundem  
të fërshëllej  
si zogjtë dhe flladi përtej në pyllin e ri!  
(Atëherë të më qaje me ligje, nënoka:  
Mjerë nëna për shpirtin, birooo!)

Sytë e rinisë udhëtojnë me muc.  
Kurdoherë më pyesin: hə, ç'ke bërë?  
Jam një krijesë e mbështjellë  
me drita dhe hije,  
për këtë arsye vazhdoj luftën time,  
dhe kënga lëkundet në të gjitha notat.




## MBRËMJE NË FAMILJEN E RE

Unë e shoh gruan me laps dhe letër  
si filozofe dhe më vjen për të qeshur.  
Llogarit me durim shpenzimet e ditës:  
kaq buka, kaq lakra, kaq mishi,  
kaq peri, sapuni, buratinoja, libri.  
Një vizë, një shikim pa shprehje nga unë.  
Më ka lodhur një dëshirë e ndrydhur

përqafimi,

shtrij krahët dhe në ëndërr gëzimi humb,  
bie lapsi i saj në tokë dhe zihemi  
për doresh, për supesh, për shpirti,  
rrotullohem si në një valle  
qeshim potershëm dhe tallemi:  
Si thamë, si thamë? Shtatë lekë për lakra?  
Ha! Ha! Dhe dyfish për romane?  
Ia shkelim syrin në mirëkuptim  
natës shejtane.

Ajo ma mbledh në sy shikimin,  
më fut në trup erë marsi,  
me një magji të pathënë kurrë  
si gruaja dhe e dashura.



## KËNGË E RE PËR VENDLINDJEN

Jam nga ky vend i pashok në veriperëndim  
ku xunkthi çahet nga vapa dhe vala e kripur  
e detit,

kur pisha e Velës më tutje filtron

ajrin e vjeshtës,  
ku mbrëmjet e lehta peshojnë mbi kallinjtë e  
ndritshëm si zjarre.

Zgjas dorën para dhe prek det,  
zgjas tjetrën prapa dhe prek male.

Më keni parë të urtë e të qetë, o miqtë e mi?  
Më keni parë si pak mirësjellje më ndez  
shumë qeshje?

Më keni parë sa vonë më zë zemërimi  
i vështirë për t'u prapsur?

Është rrënja ime këtu, në tokë dhe në gur  
te shpirti bujar, i gjerë dhe i ashpër i njerëzve.

Jam nga ky vend ku pashë njeriun e parë,  
ndjeva dhe fola fjalën e parë,

Ai horizonti atje më mbajti duart kur u ngrita,  
ky kroi këtu më dha ujët dhe rrojta.

Është dita e parë dhe dita e fundit këtu.



## TË KËRKOVA

Ku shkove? Ku je?  
Në qytetin e vjetër.  
ka orë që pyes për ty.  
ca nuk të njohin. ∴ Po përse s'të njohin?  
Ca më përgjigjen qetësisht: S'e dimë.  
Dhe nuk dyshojnë për asgjë. . .

Kthesë pas kthese sikur më zhdukesn,  
hyj dhe s'blej nëpër kioskat e rrugës.  
Çfarë doni ju? – më pyesin shitësit.  
Çfarë doni ju, – u përgjigjem shitësve.  
Edhe ata, edhe ata  
janë në qytetin e zemrës sime.

Ku vajte? Ku vajte? – Orët mbarojnë.  
I dhimsem një shoku dhe nis më thërret.  
Mbyllen dritaret, kush nuk flet.

Iki shpejt, iki shpejt.  
Kam frikë se prej turpit  
dashuria lëshon rrënjë  
e më mbërthen për gur.

## EPITAF MBI VARRIN E SELIM HASANIT

Nëse ti mik i ardhur nga larg,  
në vend të poetit gjen këtë varr,  
thirri atij, ai të përgjigjet,  
se zemra rreh ende dhe dheut përhidhen  
kodrina.

Të rrahurat e saj braktisën trupin,  
ecin nëntokës bashkë me burime.

## VAZHDIMI I TRI KËNGËVE PËR NËNËN

1.

Ka ditë,  
ka vite,  
në fund të oborrit,  
ku nisin rrugët e gjata të birit,  
të kam premtuar shumë e shumë gjëra.  
Ja dhe pak, nënë, dhe pak sa të rritem,  
sa të mbaroj shkollën, sa të mbaroj ushtrinë,  
sa të martohem, sa të rri pak me gruan.  
Ja dhe pak, nënë, dhe vetë do ta shtroj  
tryezën,  
do të shëtis nëpër vende që kurrë s'i ke parë,  
sa të botoj një libër, sa të ecë fëmija,  
sa të mbaroj Balzakun, sa të mbaroj  
frëngjishten...  
Ti gjithnjë ke qeshur e ke thënë: Mirë, biri im!  
Dhe gjithnjë vjen prapë rrotull pa pushuar  
kurrë,  
dhe zelli im prej shpëtimtari përqeshet  
nga koha,

Tani nuk të premtoj më, nënë,  
jam bir i rrugëve të këngëve.  
Këtu janë kursimet e shpenzimet e mia.  
Të kanë thënë se yt bir kokulur shkon në botë,  
ti e di dhe qesh, ti e di dhe hesht.  
S'është turpi, as pendimi, por torba  
e pengjeve  
që rëndon në qafën time dhe më mban  
me sy nga toka.

2.

Atje ku kam lindur,  
mbi një hasër të hollë.



(për të bërë gjumë të lehtë)  
tani vonë  
është shtrirë nëna ime e plakur.  
Për hir të syve të saj në prehje  
era përjashta fërshëllen shumë lehtë,  
e megjithatë i fanitet sikur  
një fëmijë ka mbërritur prej larg dhe troket,  
troket majtas, djathtas  
nga zemra, nga gjiri,  
e sytë e saj i hap  
një mall biri.

3.

Kanotiera ime në pìrgun e teshave.  
E pashë nënën si e hoqi

dhe i mori erë djersës,  
Ajo erë e njohur,  
e pandier qyshkur  
i dha një minutë kënaqësi.

Nëna dhe biri s'bëhen dot dy.

## PORTRET I VËSHTIRË

Nga mëngjesi në mbrëmje,  
nga e diela të shtunë  
mban një buzëqeshje të prerë në masë.  
Asnjë santim më pak,  
asnjë santim më shumë —  
grimasë.

Të hënën mendova  
se çon dashuri  
me një bukuroshe.

Të martën mora vesh: nuk ke-mjerim-asnjë  
shoqel

Të mërkurën shi radioaktiv kishte rënë,  
qumështi i fëmijëve nuk u shit në pazar. . .  
Ti qeshje dhe nënat bujare të quajtën të  
marrë.

Të enjten heshta, heshta të premtën,  
më ndiqnin pas dy buzë si leqe.  
Shpirtin ma lodhën, mendjen ma vodhën-  
nëpunës i mesëm, moshë e mesme. . .

Të shtunën thashë: Po natën, natën  
kur kapsat e buzëve shkrehen  
si do të jetë fytyra jote?

Kaa mendimliga janë planet që thur? — pye-  
ta të dielën.

## NJËRËS QË I LËVDOVA SYTË

I paçë lëvduar dy sy në Vlorë,  
Shkoi stina: plazhi u mbyll dhe ika.  
Mora një letër. Ajo s'kishte fjetur gjer vonë,  
s'ndihej mirë me të gjitha.

U drodh drita në syrin tim të tronditur  
dhe askush s'më ka ditur.

## U KTHYE MAGJEPSJA

U kthye magjepsja-sa mirë-dhe përsëri  
lulet e verës i pashë në ëndërr,  
ëndrrat e gjumit i pashë në rrugë,  
brenda një përralle breth universin,  
brenda një flete fshihem, humb  
si në fëmijëri. . .

Prej një përkëdhelje qesh nga gëzimi,  
prej një fjale të ashpër qaj nga trishtimi,  
Një rreze dielli e shoh me gaz:  
Pranvera! Pranvera! Urrraaa! – bërtas  
si në fëmijëri. . .

Me stisje gjahtarësh rend nëpër vreshta,  
ata burra, them, pas do t'i lërë vdekja. . .

U kthye magjepsja.

## BASHKËFSHATARËT

Një vajzë e bardhë vibron  
në ajrin e plumbtë të zhegut,  
përmes vetima binarësh të hekurudhës së  
hollë,  
kthej kokën prapa, ajo humbet në reflekse,  
bëhet një njollë.

Unë ndjek përtueshëm kalldrëmin  
për të dalë në asfalte,  
dhe hapat pas shpine i ndiej, fëshfërimën e  
krahëve,  
sikur t'ia shoh fytyrën, ta thërras në emër loj-  
caken,  
ta kap pa u shndërruar në foton drite, në ajër.

Po s'kapet ajo, është hije, trillim, imazh,  
lojë e qeshur e mbresave që mora nga fusha,  
ku 12 bashkëfshataret e mia i pashë  
të bukura, asnjëra s'ish më e bukura.

Secila shtathedhur me ninëzat e gjalla,  
plot vizatime dëshirash për udhë, fëmijë dhe  
prova.  
Ua di foshnjërinë mbështjellë me qiell e pë-  
rralla...  
Sa shpejt ka shkuar mbi akrepat koha!



## GAZMORE PËR 1 PRILLIN

Është një ditë e bukur sot në Tiranë.  
Vajzat thonë «po»-të e vonuara dhe qeshin,  
djemtë zemërohen e thonë: S'u duam!  
S'ka asnjë çudi që shatërvanët nxjerrin li-  
vando,

normalisht një shef përqafohet me vartësin.  
Nxjerr t'i japë një cigare, e pyet: A keni  
ndonjë hall?

Dhe falet prej tij për pyetjen e kotë.  
Është mes nesh seriozi që thotë gjithnjë të  
vërtetën.

Përse nuk gënjen? — i themi me shaka.  
Seriozi vë buzën në gaz. Kaq mjafton,  
edhe ai është tani më 1 prill.

S'më bëhet të vete në shtëpi,  
humori i hollë i gruas më pret,  
dua të më «gënjejnë» fëmijët përsëri,  
t'i besoj fëmijët, t'i kënaq fëmijët  
gjoja pa kuptuar ç'po ndodh në këtë botë,

## MË DHEMB NJË GRUA

Më dhemb një grua e hollë-  
në verandë, në muzg,  
mbështillet me heshtje të plotë,  
mbështillet me natë.  
Atje vonë e kujton, e ngre, e shkund  
një sirenë treni, larg...  
E shoh në mëngjesin e ri të hequr dhe të  
zbehtë,  
me çantën në krahë nxiton të kapë urbanin,  
herë qesh me forcë, herë dridhet si fletë  
kur sheh bashkëshortët si puthen me sy dhe  
ndahen.

Afrohet dita te nata dhe del e krehur,  
e lyer kujdesshëm në buzë dhe në faqe,  
përpiqet ta joshë burrin të kthehet herët  
pa dehjen e pijes së gjatë nëpër parqe.  
Vonon, vonon dhe pika e lotit të nxehtë  
kosit një tjetër fije të qerpikëve të gjatë...  
Mbështillet me heshtje,  
mbështillet me natë.

Trupit, dejve, grushtash  
hidhet zemra ime që ther:  
Ik më mirë! Lëre më mirë atë burrë,  
sikur ta dish se s'bëhesh kurrë nënë!

Kujtoj të dashurit.  
Mos jam për kënd vrer?

## AKUARELE

### 1. *Në bregdet*

Nga shtrati i detit dalin furtunat.  
Shikoj nga bregu si përkulen grunjat,  
përkulen e çohen fijet e blertadertin tim qajnë zogjtë nëpër plepa.

Dua ta vë faqen  
në një fletë jeshile.  
Në qoftë se fleta prishet,  
të prishet faqja ime.

### 2. *Fëmija*

Në livadhin e prillit  
kalojnë gjashtë gjahtarë.  
Hapat rëndë i hedhin,  
tërfilin e shkelin.

Nga degët e pemëve ikën ndonjë zog.  
Në krahët e mi qan një fëmi.

3. *Toka në shkurt*

Tani duket se asgjë s'po ndodh,  
po lexojë gëzimin e botës në shkurt,  
që ka në ballë sytë e gruas shtatzënë.

Ju lutem, mos shkëlmi rëndë në tokën e  
shkurtit!

4. *Sot e diel, 6 shtator*

Sot e diel, 6 shtator,  
I thashë nënës: Të pimë!  
Asnjë festë s'ka në botë,  
asnjë njeri i madh s'ka lindur,  
Sot e diel, 6 shtator,  
u rindeshëm me mikun.

5. *Me atë trillin prej poeti*

Me atë trillin prej poeti  
kërkoj një varkë në sytë e tu,  
krahët e lirë të zogjve,  
fushën dhe detin.

Ti kokën ngre dhe shoh  
fytyrën time të qeshur.  
Krahët e lirë të zogjve,  
varka e lehtë, deti  
sprapsen pak përpara meje.

6. *Më lajmëron zemra*

Më lajmëron zemra se po afrohesh...  
Ndalem në rrugë,  
ndez një cigare.  
Si mbi një luzmë bletësh të reja,

mbi të rrahurat e zemrës sime mbështetem  
dhe pres. . .

7. *Mesnatë*

Luftën me gjumin pas pak do ta humb.  
Sikur në një ëndërr të shihem,  
jam zgjuar.

8. *S'harrohem i më*

Dje, sot-gjithmonë në lëvizje,  
me një bllok të vogël shënimesh në xhep,  
Udhëtojnë me mua fusha dhe male,  
emra që gjejnë fytyra njerëzish. . .

S'harrohem i më dhe në u harrofshin fy-  
tyrat.

## KY BURRË QË RRON MATANË DHOMËS SIME

Ky burrë që rron matanë dhomës sime  
shpeshherë shkon e vjen nëpër takime.  
Për Luftën e Dytë flet në vetën e parë...  
Atëherë ka qenë i ri, 15-vjeçar.  
I heq kapelën guximit t'asaj nate  
kur ngjiti mureve një duzinë me trakte,  
kur doli fluturim në demonstratë,  
kur hodhi një karrige në barrigadë,  
kur kapi kodrën e rrugës për te malet  
dhe zbriti në qytet me çlirimtarët.  
Por ja se kapa më rraset shpejt në kokë.  
Matanë murit dëgjon ca cingërime.  
Pastaj një grua: «S'paska n'Evropë  
për tualet takëme më të mira»?  
N'Evropë është dhoma ku dëgjoj e dridhem.  
Ku vallë jetuakan fqinjët matanë murit?  
I kanë dy vajza si dy karafille,  
veç bukë të bardhë e dinë jetën e grurit.  
Njëzet i mbushi dhe hyri për nëntëmbëdhjetë  
ajo e madhja, gishtpambukëbardha.



Një kopsë po t'i bjerë s'di ta qepë,  
raporte për aksione nxjerr e para.  
Dhe babi shkon e vjen nëpër takime,  
dhe thotë «luftuam për një botë të re».  
Dhe floku fluturon kapelen time,  
dhe gjuha më rëndon si një vare.  
Mjaft! Mjaft! Një mur i hollë na ndan,  
por jemi më larg se largësitë.  
Bota e re shtrin gishtin ta shpallë  
një plangprishës të vonë të Luftës së Dytë.

## NJERIU

Më zu thëllimi në mal

të Munellës.

I vetëm ecja... T'ua them çiltër:

ngrica ngriu kujtimet,

frika thirri rreziqet.

Papritur pashë fjolla të holla tymi.

Vrapova nga zjarri, siç e merrni me mend,  
po në çast m'u lidhën këmbët dhe ndala.

Prita ftesën e zotit të zjarrit, njeriut.

Po njeriu nuk ishte.

Më kot përgjova, e thirra, më kot e prita.

Kërcenin në ajër shkëndijat,

më thoshin: tani ka ikur.

E lashë dhuratën për shpresën dhe shpëtimin,  
i rashë në gjurmë udhëtarit. Përpara meje

ishte,

dhe gjaku më ngrohej, dhe kujtimet zgjohe-  
shin.

## KËNGA E MBJELLËSEVE TË ORIZIT

Yje trazon e shuan era,  
bashkë me dritën në fushë zbresim,  
me njëra-tjetrën lozim, qeshim.  
Është maj, maj orizoresh të reja.

Si qelqe ndrisin pikat e vesës  
mbi barin e përtërirë.  
I thyen shpejt dielli me rreze,  
mbaron dhe loja jonë e mirë,  
dhe loja jonë e mirë.

Ne turbullojmë ujët e ftohtë  
që fara të fshihet nën baltë,  
dhe vuajmë pak se nuk durojmë  
kurrfarë turbullire ne gratë,  
kurrfarë turbullire ne gratë.

Farën e hedhim me drejtësi,  
tre katër duar për metër,  
megjithëse nën ujë s'e sheh njeri  
veç zemrës sonë të dhemshur,  
veç zemrës sonë të dhemshur.

E butë toka dhe trupi hepohet,  
gërsheti i flokëve nga balli rrëzohet.  
Na rreshken buzët, na skuqet mishi,  
nën zë këndojmë: është i lirë orizi,  
këndojmë: është i lirë orizi.

Po farën e hedhim me drejtësi  
që kilen ta blejmë me tetë,  
dhe toka të nxjerrë mbi ujë me fuqi  
një qilim të bukur, të blertë,  
një qilim të bukur, të blertë.

## VDEKJA E GJYSHES

Në gjurmë këmbësh të zbathura bahçes  
shëtisin larat e diellit.

Dje ecte gjyshja.

Po ngrihet bari.

Po pres të kthehet.

Thonë ka mbathur këpucë të reja,  
thonë ka veshur xhamadanziun.  
Thonë e lodh etja.

Tani është behar. E di,  
por qiejt do të qajnë në vjeshtë.

## NË PESEVJETORIN E NJË LIRIKE

E shndërruar në vajzë, në vajzë shumë të  
bukur,  
kishte hyrë pa u ndier në dhomën time të  
punës.

Më vështronte me ngulm sikur m'i thërriste  
kujtesës,

lozanjonte me trup, kafshonte buzët,  
i buzëqeshte hutimit tim tamam si fëmija  
që kap të atin në mendime të thella.

– S'më prisje? – tha duke fshehur  
pak turp të mirë nëpër teshat e bardha.

– Si sot pesë vjet u takuam  
atë natë, atë natë! . . .

U afrova pa folur, e përqafova lirikën time,  
pastaj i ngrita epikat, gazmoret,  
elegjitë, vjershat antiburokratike:

Në këmbë të gjitha!

I uroni njëqind vjet motrës suaj të bukur.

## NJË BREZ NËNASH

Një brez nënash të urta, të mira  
mbyllin sytë e ikin nën tokë,  
pa mësuar mirë shkrimin e këndimin  
e shumë e shumë gjëra që ka shpikur nje-  
rëzimi,

Mbi varret e tyre fëmijët qajnë-  
poetë dhe shkencëtarë.  
Ndër gjithë dituritë e botës, nëna  
është dhemshuria-ditura e zemrës.

## QYTET, QYTET

Qytet, qytet-  
mëngjeseve herët  
përkundesh në avuj të bardhë, luhatës.  
Ngadalë shfaqen ballkonet, antenat  
si krahë që largojnë çarçafët e natës.  
Dhe mua më duket se avujt e brymës  
rrëmbyen diçka prej teje, qytet,  
e ngritën lart bashkë me dritën  
dhe zbukuruan qiejt.

Në gjashtë rrezet e diellit përshkohen,  
nëpër avujt e hollë, nëpër hapat e shpejtë.  
Detyrat renditen në kokë, më pret  
një rubrikë në gazetë.  
Nëpër aromat që dalin nga mëngjesoret rre-  
shqas,  
u iki ekspresëve kryelartë, buzagaz.  
Jam i gatshëm për punë, qytet, qytet  
që s'më fut të tërin në hije,  
që s'më lë të tërin në diell.



## VIZATIME NGA ISHULLI I LEZHËS

Është dimër dhe reja grisjet ndër kallamishte,  
nga gojëzat e valëve të lumit ngrihet avull i  
bardhë.

Lumi flet, lumi thotë fjalë.

Vajzat e veshura hollë në breg  
plot trupin e kanë me të qeshura  
dhe fytyrën me hijen e një dashurie,  
me hijen e një pritjeje të shpallur.

S'kam dashur të di se çfarë flet lumi.  
Njeriu i Ishullit të pyet së pari për gruan,  
pastaj për shëndetin dhe fëmijët,  
pastaj për shokët e fare për postet.

Njeriu i Ishullit kënaqet me njeriun.

## COPËZA BIOGRAFIE

*Migjeni (1911-1938)*

Në moshën 22 vjeç  
këputi ortekun e ngricave të durimit,  
por ai s'festoi me asnjeri.  
Të afërmit e ndien: ai hante pak,  
flinte pak dhe fliste pak.

Në moshën 23 vjeç  
qeverinë e zuri kriza.  
Popullit buka i mungonte.  
Në varr të qesëndisë së tij  
ranë tempujt e mykur.

Në moshën 24 vjeç  
nga kasollja e mjerimit  
i shënoi me pishtarë  
ato netë butaforike  
dhe zbuloi kriminelët.  
Në çdo frymëmarrje të tyre  
njerëzit e thjeshtë tradhtoheshin.

Në moshën 25 vjeç  
vdekjen nga afër e pa.  
Atëherë nxitoi, nxitoi të shkruante,  
nxitoi të shuhej, nxitoi të heshte  
para se ora e ligë ta këpuste.

.....

Në moshën 27 vjeç.  
Motrat dhe miqtë futën në tokë  
trupin dhe vdekjen e poetit.

.....

Në moshën 75 vjeç. . .

## KËNGË DASHURIE

... Emra njerëzish, emra sendesh...  
Se si tingëllojnë në zërin tënd!  
Dyfish zbukurohen fushat me grurë,  
kur i vështron, kur i përmend.

I dua shumë sytë e tu aq të gjallë  
me një dhembje të lehtë prej vajze të mençur,  
sikur të vjen keq që për to lë kokën  
më parë se të shkoj në thellësinë e tyre.  
Më fol, pra, për rrugët ku ke shkelur!  
Tregomë librat që ke lexuar!  
Burimet ku ke pirë, bisedat vetmitare,  
dashuritë, shpresat, gëzimet, zhgënjimet,  
ngjarjet e thjeshta që t'u bënë virtyte!

Vështrohem prej teje —  
dritare-dritare më bëhet trupi.  
Toka e lashtë kthen magjepsjet e fjetura,  
më duket pak fjala «të dua»,  
më duket pak përçafimi, flijimi,  
Në jetë kërkuj ku ka një luftë  
për t'u fituar nga të dashuruarit.

## KUR NDIZEN DRITAT

*gruas*

Është një çast fare i shkurtër,  
kur ndizen dritat, më dhembin dritat.  
Mbyll sytë e kthehem me shpinë nga rruga  
e nga qyteti.

Të dua ty, të thërras ty  
dhe kam një nëmë për mirësinë tënde.

E ndez më vonë  
dritën time në dhomë,  
Pa një krehër me dorezë,  
pa një fije të gjatë floku,  
pa një karficë  
është dhoma.

Mbyll derën, librin, fletoren e reportazheve,  
pres sa të më kalojë, pres sa të më kalojë.  
I trembem hijes së vetme, i trembem  
përmallimit  
që nganjëherë na bën t'u rëndemi miqve.

MOS U BËJ SHOK  
ME NJË QË PËRULET PËR T'U NGJITUR

Dëshiroj të të shoh të pazhgënjer,  
të patradhtuar. —  
Mos u bëj shok me një  
që përulet për t'u ngjitur.

Edhe kur rrotullohet në krahë të një vajze,  
kur ngre në nivele humori marrëzitë  
e ndonjërit,  
kur ha pa pirun, kur shëtit nën shi;  
sepse është i panatyrshëm. Tani u kuptua:  
ai i **duron** këto çaste kalimtare.

Nësër, nesër-nëse ngjitet nesër,  
më kot pret prej tij një telefonatë,  
një ftesë për kafe, për shëtitje.  
Dëshiron të lajmërosh sëmundjen e fëmijës.  
Dëshiron të thërrasësh për diçka. Më kot!  
Zëri yt nuk arrin veshët e ish-shokut,  
përplasat në zbrazëti dhe shuhet. . .

Dëshiroj ta hash me shëndet bukën tënde.  
Dëshiroj ta kesh shëndet bukën që ndan  
me mikun.  
Dëshiroj të ndihesh i lumtur sa të të kujtohet  
shoku.  
Dëshiroj t'i heqësh një shkallë karrierizmit —  
mos u bëj shok me atë që përulet për  
t'u ngjitur.

## TË DIELËN HERËT

*motiv popullor*

Të dielën herët ika në male  
i paëndërrueshëm më prej teje.  
Papritur kisha ndërruar pamje  
si lulezodat poshtë një reje.

Të thashë mirë vafsh dhe arsye s'kërkova.  
E thjeshtë qe: një tjetër deshe.  
Në pragun e ëndrrës sate qëndrova,  
unë dilja, ai hynte,  
unë qaja, ai qeshte.

Të dielën herët ika në male.



## AJO NUK E DINTE

I thanë gjyshes sime se nipi i saj  
do të vejë në konkurs për aktor,  
merr nam sa të duash, po të dalë faqebardhë.  
Gjithashtu, një rrogë të mirë boll.

Por gjyshja ime s'u ngroh as u ftoh,  
pa ditur rreth profesionit,  
në odë pas një perdeje e vunë të shohë  
stërvitjen e rreptë të aktorit.

Unë trashja zënë, holloja zënë,  
ndërroja fytyrë, çaloja.  
Herë si Tartuf, herë si Hamlet,  
me radhë... si Jagoja, Xhivola.

Nganjëherë vija te vetja ime,  
jo fort lehtë. Pra, kisha talent...  
Pas perdes dëgjova ca ngashërime,  
ish gjyshja ime e shkretë.

Fytyra e saj ish zverdhur e mpirë,  
vinin e i shkonin njollëza vishnje.  
Ajo kurrë s'kishte vënë tjetër fytyrë  
mbi atë, nën atë që kishte.

Unë geshë llahtar, tmerr e kob!  
Moj shpirt, po luaj lojë!  
Jam nipi yt këmbë e kokë  
dhe aspak një demon i pabojë.

Po ajo nuk e dinte se ç'ishin aktorët  
veç dinte këtë tjetrën:  
se njeriu që vë fytyra të ndryshme,  
humb të vetën.

## DIMËR PASKA QENË KUR...

Dhe prilli erdhi,  
dhe toka e ndjeshme nga trokitja e çapave  
menjëherë nxjerr sipër vetes livadhe.

Rreth trupit të hollë si fërshëllima  
elipset e ajrit vërtiten si stolira.

Të tutë janë ata krahë të zhveshur  
që tani shkëlqejnë nën diellin e nxehtë  
dhe sytë m'i vrasin?

Dimër paska qenë atëherë  
kur dashuria-mëmë çudirash  
thellë nëpër sytë e shoku-shokut  
na kishte fshehur.

## PROVA LUMTURIE

Ja, unë qesh dhe përhidhem rrugës,  
në shëtitjet e mbrëmjes jam me të tjerët,  
gjithmonë më pret një mëngjes më i bukur...

A doni të tjera prova lumturie?

Më mungon diçka. Punoj ta kem.  
Nëse vonon e shpjegoj vonesën.  
Në mirëkuptim shkon ëndrra me jetën.

A doni të tjera prova lumturie?

Cdo lloj mrekullie punën ka mëmë.  
Jo veç mrekullia. Dhe nderi. Dhe gazi.  
Dhe fjala e drejtë. Dhe veshja e thjeshtë.

A doni të tjera prova lumturie?

Bukën përherë mund ta blej me kusure.  
Na njohin tryezat ku hamë çdo natë  
me lugë të zakonshme, me shije të artë.

A doni të tjera prova lumturie?

Zë miq përditë, jap e marr me ta  
shpirt, dritë e mendje plot me kuptime.  
Gjithçka ma thotë emrin si një bashkudhëtar.

A doni të tjera prova lumturie?

## PRAPË FËMIJËRIA

Ja fëmijëria, prapë fëmijëria...  
Ëndrra më duken livadhet e blerta  
ku këmbkat e vogla lënë gjurmë të lehta  
sikur ka shkuar mbi bar një hije.

Tungjatjeta, kohë e pakthyeshme!  
Atëherë nuk gënjeja, por luaja.  
Kisha kultin e burrit, nëpër ditët me diell  
vrapiroja livadheve.  
Natën lakmoja fuqi dhe mustaqet...  
Sa ngadalë shkonte koha.

Tani jam ati i fëmijës, nganjëherë shok.  
Pakkush më ka parë  
të vrapoj pas pyjeve. Netët i dua shumë,  
shëtitjet nën pemë, kur heshtja çel horizontin  
nga erdha...  
Shshshshsht! Kam kultin e një fëmije...

## VELA

Në majë të mallit  
hipa dhe pashë Velën.

Ajo bora e saj  
po lan diellin. . .

Ku janë tani dy burra moshatarë,  
këmbeheshin kokulur nëpër shtigje,  
në sy e fshihnin mallin që i digjte  
për të ndërruar një duhan, një fjalë.

Kundër të dyve e me të dy kam qenë.  
Nderin e trimave që duhen u dhashë.  
Shpatit me borë ikën haprëndë.  
Ika dhe unë një ditë  
dhe më s'i pashë.

Tani mëmërin brenda meje një pyetje:  
A shkelin në gjurmë të njëri-tjetrit?  
A borën prishin në vende të ndryshme  
ata dy burra sikurse dikur etërit?

Në majë të mallit  
rri dhe shoh Velën.

Ajo bora e saj  
po lan diellin. . .

Sillen hapësirës trumba elipsesh —  
mesazhe të bardha dallëndyshesh.



## NË MALE BIE BORË

Në male bie borë, në fushë bie shi,  
veton një vajzë në sytë e mi.

Shtigje mes reve hapin rrufetë,  
ndër mjegulla era hap korridore,  
nga shumë drejtime flokë të verdhë  
fryjnë si flakë nëpër fjolla bore.

Vetimë e sertë, as e zyrtë, as e qeshur,  
largohet, humbet diku humbëtirës . . .  
S'kam lënë me të asnjë ditë për t'u pjekur?

Në male bie borë, në fushë bie shi,  
veton një vajzë në sytë e mi.

## JAM ENDE I RI

Jam ende i ri – hiqmuni qafe,  
gjuetarë gabimesh, klientë të bezdishëm!  
Shikoni! Në rrugët e mia të thjeshta  
gjithmonë më bëjnë shenjë sekrete të reja,  
stacione ku nisen për udhë mendime,  
një qeshje vajze, dashuri të lashta  
si ajri, si uji, si fluturimi.  
Shikoni! Po rritem, po rritem, po rritem. . .  
Pa luftë me ju; fitoj mbi ju,  
gjuetarë gabimesh!

Jam ende i ri.

## BURRAT E FËMIJËRISË

Janë plakur e pak i shohim në rrugë,  
në spitale bien shpesh e më shpesh tani,  
krejt trupin ua nxe një këmbë pantallonash  
sikur janë të vegjël, fëmijë.

.....

Po malli për ta është i madh, i pafund,  
sa kemi një ngasje të hyjmë në kopshtie,  
të këpusim një mollë të pabërë si hajdutë,  
të heqim zvarrë një degë hardhie.  
Nuk duken gjëkundi? S'vrapojnë? S'gjëmojnë?  
Baresin të heshtur pas xhamash, pas grilash?  
Por ne përrallat në çast do harrojmë,  
do nisim të qajmë për një tufë trëndafilash. . .

Atëherë këpucët urgjent do kërkojnë,  
do vijnë te ne më parë se t'u shkojmë.

## TELEFONATË NGA KABINA NË RRUGË

Miq! Shokë! Njerëz të mirë!  
Matanë këtij xhami është pijetorja.  
Rrezet e dritave nëpër mur,  
si foshnja nënën kur humb në gjumë,  
i tundin llambat:  
Ikim! Ikim!

Nën to tre burra pijnë «për fitoren»,  
pijnë «për rrezimin» e një talenti.  
Me radhë thonë:  
— I saktë stërkëmbëshi.  
— Sipër qe, poshtë ra!  
— Faqe së shoqes qan: Ha! Ha!  
— Numëron yjet për të mbledhur mendjen!  
Pastaj përtypen pa futur gjë në gojë,  
qeshin njëherësh, përtypen prapë.  
Thonë: S'mblidhet më koka e rënë!  
Në mill të syve të turbulluar  
secili fsheh dëshmi të rreme.  
Si biri nënën që humb në gjumë, ju shkund.

Ju, vëllezër! Miq! Shokë!  
Ja ku janë tre!  
Ja ku është një!  
Ndajeni gjyqin me presë çeliku!  
Më jepni provën e zemrave të prekura!

## BASHKUDHËTARE KAM DASHURINË

Kjo verë iku, iku përtej reve. . .  
Filluan shirat e vjeshtës.  
Një lëmsh dashurie  
mblihet prapë këtu midis zemrës.

Është lëmshi i vjetër, i djeshmi, i pardjeshmi,  
tani s'e kujtoj ditëlindjen e tij.  
Apo ka lindur bashkë me mua?  
Apo bashkë me njeriun qindra vjet më parë?  
E bart në të gjitha rrugët ku shkel,  
në letrat që shkruaj, në fjalët që them,  
e lëmshi shkridhet, rrjedh e kurrë s'mbaron,  
thuret livadh i pafund nëpër gjurmët  
e njerëzve,  
kthen përballë meje fytyra qytetesh  
dhe miqsh. . .

Kjo verë iku, iku përtej reve —  
filluan shirat e vjeshtës.

Po rrekem më mirë ta shpjegoj  
lëmshin e zemrës,  
por koha nuk pret dhe vetë dashuria më nis  
Shqipërisë. . .

## B A B A I

Në mur një pasqyrë,  
në pasqyrë – unë.  
Vërej: kujt i ngjaj?  
Këtë fytyrë dikur  
e ka pasur babai.

(Me daltë e penel  
koha ia ndërroi pa u ndier. . .)  
A thua prandaj  
nëna më do  
mbi fëmijët e tjerë?



## CILIDO MUND TË NISËT PËR ZBULIME TË MËDHA

Po të mos mësonim gjeografi në shkollë,  
qysh nesër do niseshim të zbulonim Amerikën.  
Megjithatë mos u trishto –  
cilido mund të nisët për zbulime të mëdha  
në rrugë të vështira,  
plot dallgë, shpresa, gëzime marramendëse,  
kur çdo shkrepje sysh fut në shpirt  
pamje të reja.

Nëse ty s'të tërheqin grimcat e atomit,  
ja ku është një burrë që për zakon  
ia heq kapelen. Kërko të provosh  
me të drejtë e pa të drejtë?  
Mëso si sillet me paranë, me gruan,  
sa thellë e ka qeshjen e bukur të buzëve,  
a i ka sytë pragje të shkelur nga drita?  
Futju në pyll të mendimit, zbulo  
çerdhe ka apo gracka.

Mos u kthe prapa, ec nëpër të, dil  
dhe na thuaj  
a duhet t'i heqim kapelen.  
Nëse nuk mund të krijosh soneta,  
kuptoi ata që të bëhesh i bukur.  
Nëse nuk shkon për fluturime kozmike,  
përpiqu të dish pse qan një fëmijë?  
Nëse s'të nxit dëshira nëntoka,  
nisu për zbulim, makar të vetvetes!  
Origjinën, të tashmen dhe të nesërmen kërko!  
Ja pra, cilido  
mund të niset për zbulime të mëdha.

## BIRI IM, SA TË NGRIHESH NË KËMBË

Biri im, sa të ngrihesh në këmbë  
dil përcillmë te porta si zot shtëpie!  
Të lutem shumë, mos qesh si foshnje,  
të mbetesh kurdo zoti im, biri im.

Të qofsha falë, bir i babait,  
një vit e ca në një mur  
ndeshjet, armët e trimit gozhdoj.  
Në vend të ninullave të këndoje lirika dashurie,  
të gjithë i zë gjumi vetëm ti më vështron  
i magjepsur.

Ngreu në këmbë!  
Babai po ikën!  
Një mijë takime humbën durimin  
me male, me njerëz, me ujëra, me pyje...  
Gjuha t'u shkojë dëshiron, t'u japë  
vulën dhe format e fjalës së zjarrtë.

Kur të kthehem, me një puthje  
do të të zbukuroj.

## NJË VERË E HERSHME

Vargje dhe vargje dhe punë e madhe...  
«Po s'u bëra poet, do të vdes».<sup>1</sup>  
Isha në moshën 19-vjeçare  
dishepull i Bërsit skocez.

Ish verë e thatë, me nënën dhe atin  
zbrisim në fushat e verdha.  
Mërzia kish pushtuar fshatin,  
dhe pluhur shumë ngrinte era.

Ahi, shi! S'po shohim re,  
vapa ndez gurin e malit.  
S'i bëjmë sivjet paratë për TV,  
i thoshte nëna atit.

Larg nga veriu bubullimat  
në sytë e tyre vetonin...  
Nga mendja ime mërguan rimat...  
dhe pashë çuditshëm babë Gjonin.

---

<sup>1</sup> Varg i Robert Bërsit

S'më duhet, thashë, paraja, e mjera!  
Vargje bëj sa vjen nata!  
Dhe jam pasaniku më i madh që ka Lezha,  
sado që s'kam letra në banka.

Babai zuri ijet dhe kukurisi:  
Të paça, moj bankë e birit.  
Shpik vjersha? Mirë, Po u tha misri.  
Ani. I çojmë shkronja mullirit.  
Megjithatë mirë s'e dimë  
sa shkon hesapi i vargut. . .  
Mblodha buzë e vura mërinë  
ndaj atit.

Dhe emrin e Bërnsit ndolla në buzë,  
eca i nxehur mes pluhurit:  
Jam pasanik dhe i jap gjithkujt  
nga halli dhe gëzimi i burrit!

... Më besoi shpejt dhe qysh atëherë  
im atë më dha leje krijuese.  
S'bënte në dhomë zhurmë e poterë,  
me nënën u soll si me një nuse.

Se biri shpikte matanë murit  
hallin e gazin e lirë të burrit.

## RA DHE NJË DITË

Po çahet dielli, e ndiej, dhe dita bie.  
Pa kuptuar as vetë nxitoj hapin,  
turrem poshtë nga fusha.  
Kapërcej mbi kodrat bojgjake të avujve,  
mbi mizërinë e fyejve që rrit toka  
në mbrëmje. . .

Sa e shkurtër kjo ditë, sa e shkurtër kjo ditë!  
S'më ka tepruar minuti, ora e bardhë.  
Qoftë nga kjo kam të drejtë të përhidhem,  
sepse nuk e njoha zbrazëtinë e pritjes,  
duke lakmuar me etje të egër  
atë që do të vijë, atë që do të kem.

Vjen çasti dhe ndalem. Zogu çerdhen përkund.  
Dielli futet në det, dita futet tek unë,  
ajo që ka ecur këtu e te bota,  
këtu e te tjetri,  
këtu e te vetja

dita e punës, e dashurisë dhe asgjë tjetër.  
Qoftë nga kjo kam të drejtë të fle si qengji,  
sepse s'kam endur ligësi e plane shkatërrimi.  
Nuk ekziston i thjeshti që u helmua prej meje.  
Nuk ekziston i ligu që fle rehat prej meje.

Tani në ajrin e natës, mbi fushat e gjera  
shëtit një ëndërr fshatarësh për ditën e re,  
e cila ngjan por nuk e përsërit ditën që iku —  
«të vetëkënaqurën», «të përsosurën»!  
Ky lak s'bën më për këllqet e mia.



## EJA NË BOTËN E POEZISË

*Si jetojnë njerëzit pa poezinë?*  
Ricos

Të thërras me gjithë shpirt, si bujar, si fisnik  
megjithëse i padashuruar:

Eja në botën e poezisë!

Këtu jeton flora dhe fauna që flet,  
dhe bukuria jote...

Si do magjepsesh nga bukuria jote!

Menjëherë do të kërkosh rreth e përçark  
djalin.

Të thërras ty, jo vetëm femrës së bukur,  
jetës sate.

Eja në botën e poezisë, në mos për mua  
për një tjetër.

Në mos për një tjetër, për veten tënde  
përpiqu të vish!

Eja! Eja! Nga dashuria  
vetëçelen portat,

të dalin përpara rrugët ku nderi jep  
sendet dhe gjërat këtu kanë veç një faqe,  
idhujt janë — çfarë fati — dishepujt e njeriut,

ndërsa demiurgët s'i nxë asnjë numër  
gjersa shumica prej tyre s'kanë lindur.  
Pra eja, eja!

Po thërras me gjithë shpirt: po të ish  
krijesën e dashur të vegimeve të mia,  
njeriut të thjeshtë do t'ia vija gishtin  
që për asnjë premtim s'i vidhet poezisë.

## KAM PARË NJË HERË

Kam parë një herë një burrë. Burrë?  
Duke u shkrirë si qiriri  
para syrit – zjarr të shefit.  
Gërmonte në tokë  
një gropë.

Kam parë një herë dy palo burra!

## KËRKESE NË MOSHË TË RRRITUR

Nënë, atë, motra, vëllezër!

Kam qenë një djalë i urtë, komod,  
nevojtar pozash gëzimi kurdoherë,  
një hap s'e kam hedhur pa shpenzuar ju  
ndjenjë, kohë, djersë, para, shpirt e merak  
ditë për ditë.

Kam qenë një djalë mamaje, buzëhollë,  
më keq akoma: sharlatan.  
Ngjitja shkallët e viteve me valixhe shkollari,  
me diplomë nëpunësi.

Premtoja shpërblime,  
trilloja pozita,  
paqe kërkoja nga ju, humor, qeshje,  
kërkoja flinë e përpjekjeve, ndeshjeve,  
betime u hidhja njërin pas tjetrit.

«Pas meje mbahuni», ju thosha  
dhe s'ju lija rast të më shanit,  
makar një çast të më harronit. . .

Nënë, atë, motra, vëllezër!

S'jam më i brishtë, i butë!

S'jam fare magjik, zanë e legjendës!

Ju lutem:

Mos më doni shumë, mos më doni shumë.

Djali juaj, vëllai juaj

anës rrugës, anës lules, anës shokut

rrezikon pa frikë, është i sakrifikueshëm,

Në dallgët e kohës e ka lidhur fillin e jetës.

Mos e doni shumë,

Mos e doni shumë!

## KËNGË E RRITUR

1.

Mban mend si vija e shkoja nga lagjja?

Doja të thosha të kam parë në ëndërr,

je më e mirë se në ëndërrën time,

doja të thosha. . .

Mban mend? Ke një lëmsh në grykë, thoshe ti,

Vërtet e kisha një lëmsh në grykë.

Më duket shkoja nga fëmijëria

aq shumë të doja –

trembesha se do të ishe e imja.

2.

Të dua prapë ashtu si dikur.

Krejt qenia jote shpërndan dritë dhe frymë,  
fuqia pushton krahët e mi.

U shfaqem me ngut punës dhe njerëzve  
si binjak i zellit të tyre të ndershëm.

Ti je mosha pa moshë e vajzës,  
akoma s'e di tamam sa vjeç je,

kundër vitesh lulëzon, çelësh  
po sipas meje dhe dashurisë.  
Tani e gjithmonë, moj dashuri,  
e dëbon lakminë, etjen, babëzinë  
për harxhe të marra, për shumë lavdi.  
Atë pjellë të keqe të kohës së zbrazët  
e përqesh, e tall ti, dashuri.  
Ditë për ditë po bindem se je nga kryesoret  
që i mungon të ligut.

## NËNQESHJET E NJË BUROKRATI

E pyes për hallet e njerëzve – ai nënqesh.

As gajaset, as kënaqët, veç nënqesh.

«Gjithçka në rregull» kjo do të thotë.

A s' duket qeshja si një kopsë

që lidh atë me një karrige

dhe me një rrogë?

E pyes nëse jep ndonjëherë të drejtë,

ai nënqesh, nënqesh, nënqesh,

pastaj përmendësh reciton parime,

dhe mua që s'më ka plasur cipa

zemërimi në grykë më mblidhet lëmsh;

sepse e di, sapo të marr udhën e kthimit

do ta heqë për t'u çlodhur maskën e qeshjes.

Dhe pasqyra do të thyhet prej fytyrës së keqe.



## BASHKË JEMI SHUMË

*Shokëve të mi poetë*

1.

Fëmijë të panjohur me njëri-tjetrin,  
mund të rronim, të rriteshim, të vdisnim kështu.  
Njëri në këmbë të Majës së Hekurave,  
tjetri në jugun e Jonit blu,  
tjetri nën blirët e Bilishtit tutje,  
i pesti, i gjashti, i shtati me radhë. . .  
Dhe s'do ta ndienim kurrë si humbje  
këtë mungesë të rrallë.

2.

Tani e kuptojmë se rrugët tona  
u nisën në takim më parë se ne,  
kur secili në visin e vet luftonte  
me një Bërns, a Migjen, Dritëro, Kadare. . .  
Dhe ashtu i magjepsur thërriste: O nënë,  
yt bir do të bëhet i dëgjuar poet!  
E shkreta buzët kafshonte me dhëmbë,  
plot frikë mos biri ka lozur nga mendtë.

3.

Një ditë u pamë. Si rrinim të heshtur!  
Secili për heshtjen e tjetrit shkak.  
Kritika e parë – shaka e dhëshur,  
kur i thamë shoku-shokut të dija më plak.

4.

Trokitën qeshjet, shikimet e çiltra,  
zemrat u hapën dhe hapen sërish,  
një gëzim kemi, kur poezia  
prej nesh fiton një mesazh, një vis.

## E PAKRYER

*Në Pogradec*

Pandeha se mendja këtu qetësohet,  
me valë, me vajza, me heshtje harrohet.

Tri javë hotelin e parapagova,  
natën e tretë nuk munda të fle. . .

Po iki prej Pogradecit, s'më rrihet më.

Si gjithmonë me një gjyç të njohur po iki,  
diçka e pakryer më shtyn t'i mbledh teshat  
dhe ta tradhtoj harrimin.

Një biletë të çuditshme udhe shpik shpirti,  
njëherësh për Vlorë, për Tiranë, për Lezhë,  
për te njëri e tjetri,  
për te njëra e tjetra.

Kushedi si po çel zambaku në bjeshkë,  
e ç'thonë minatorët poshtë në miniera! . . .

Poema e tyre është e pakryer.

E pakryer është detyra ime,  
e pakryer është rruga, e cila  
më pret pas çdo porte e paduruar.

## DHE NDIHEM I LEHTË...

Ku po shkon? — më ka pyetur një njeri  
në Fildanë.  
Ngado, i thashë, ngado do të shkoj  
dhe gjithkund do të vete.  
Një orë mban Lezha, dy herë aq deti.  
një vrap poezie mban universi,  
dhe prapëseprapë koha mungon  
të shkruash thjesht diçka për njerëzit...

Im atë, 60 vjeç burrë, jeton për të nesërmen.  
Dje bleu copën, sot astarin e kostumit të ri.  
Filloi hekurudha e re. Në rrugë  
qante një grua:  
«Si nuk kam një çupë për vullnetare»!  
Mbi flokët e bareshave bie pambuku  
i plepave,  
atje tej këndon deti, por tingujt s'dëgjohen  
për shkak të zogjve.  
Është pranverë, kalliri del nga foleja  
e gjetheve,  
avulli del nga foleja e tokës...

Me duart e lehta dielli zhvesh  
gjakset e djemve, llërët e vajzave. . .  
Gjithçka ka një zemër të zbuluar!  
Jam i vonuar, gjithnjë i vonuar  
të shkruaj thjesht, rrugën, mendimet.

.....

Po bëhet mbrëmje. Ku ke qenë? — më pyet një  
njeri në Fildonë.  
Ngado, i them, dhe këtu kam mbërritur  
dhe ndihem i lehtë, i paduruar  
si një livadh plot fara lulesh.

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Mëngjeset .....	3
Mosha .....	4
Ç'bisudojnë të dashurit .....	5
Ti je e bukur .....	7
Fytyrë e gjallë .....	8
Paralindja e fëmijës .....	10
Ndalem diku, vërej mëngjesin .....	13
Prill .....	15
Replikë .....	16
Mbrëmje në familjen e re .....	17
Këngë e re për vendlindjen .....	18
Të kërkova .....	20
Epitaf mbi varrin e Selim Hasanit .....	22
Vazhdim i tri këngëve për nënën .....	23
Portret i vështirë .....	27
Njërës që i lëvdova sytë .....	29
U kthye magjepsja .....	30
Bashkëfshataret .....	31
Gazmore për 1 prillin .....	33
Më dhemb një grua .....	34
Akuarele .....	36
Ky burrë që rron matanë dhomës sime .....	40
Njeriu .....	42
Kënga e mbjellëseve të orizit .....	43
Vdekja e gjyshes .....	45
Në pesëvjetorin e një lirike .....	46
Një brez nënash .....	47
Qytet, qytet .....	48

Vizatime nga Ishulli i Lezhës .....	49
Copëza biografie .....	50
Këngë dashurie .....	52
Kur ndizen dritat .....	53
Mos u bëj shok me një që përulet për t'u ngjitur .....	54
Të dielën herët .....	56
Ajo nuk e dinte .....	57
Dimër paska qenë kur... ..	59
Prova lumturie .....	60
Prapë fëmijëria .....	62
Vela .....	63
Në male bie borë .....	65
Jam ende i ri .....	66
Burrat e fëmijërisë .....	67
Telefonatë nga kabina në rrugë .....	68
Bashkudhëtare kam dashurinë .....	70
Babai .....	72
Cilido mund të niset për zbulime të mëdha	73
Biri im, sa të ngrihesh në këmbë .....	75
Një verë e hershme .....	76
Ra dhe një ditë .....	79
Eja në botën e poezisë .....	81
Kam parë një herë .....	83
Kërkesë në moshë të rritur .....	84
Këngë e rritur .....	86
Nënqeshjet e një burokrati .....	88
Bashkë jemi më shumë .....	89
E pakryer .....	91
Dhe ndihem i lehtë .....	92